



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

ZYRA E KRYETARIT

Në bazë të neneve 13, 17 shkronja k), 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, neneve 16, 19 paragraf 1.11, 61 paragraf 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-50862/18, sipas shkresës së MAPL nr. 02-129/2 datë 06.02.2020, Nënkyetari i Komunës, merr:

V E N D I M

Neni 1

Ngritet Komisioni ad hoc për përgatitjen e listës dhe shpërndarjen e pakove ushqimore familjeve në nevojë në Komunën e Podujevës, në këtë përbërje:

1. Fitore Blakçori, kryesuese
2. Jeton Salihu, anëtar
3. Halit Vërshevc, anëtar

Shpërndarja e pakove ushqimore sipas listave të përgatitura bëhet në zbatim të Vendimit nr. 02-400/03-0019977/20, datë 24 mars 2020, mbështetje për familjet në nevojë për shkak të situatës së krijuar nga Pandemia e Corona virusit Covid 19.

Neni 2

Për punën e kryer Komisioni informon Zyrën e Kryetarit përmes Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. 02-020/04-0020173/20
Podujevë, 01 prill 2020



Nënkyetari i Komunës
Nexhmi Rudari



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

ZYRA E KRYETARIT

Në bazë të neneve 13 dhe 17 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenit 54.4 të Ligjit për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera nr. 04/-L-027, neneve 16 dhe 19 parag. 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-50862/18, në kërkesë të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal të datës 13.04.2020, sipas shkresës së MAPL nr. 02-129/2 datë 06.02.2020, Nënkyetari i Komunës, merr:

V E N D I M **PËR AKTIVIZIMIN E QENDRËS OPERATIVE EMERGJENTE LOKALE**

Neni 1

Aktivizohet Qendra Operative Emergjente Lokale-QOEL në Komunën e Podujevës për shkak të situatës së krijuar nga Pandemia e Corona virusit Covid 19.

Neni 2

Qendra Operative do të jëtë në shërbim të qytetarëve 24 orë, 7 ditë në javë, deri në një vendim tjetër.

Neni 3

QOEL punët dhe aktivitet i ushtron në bashkëpunim dhe koordinim me Komisionin për veprime dhe masa kundër virusit epidemic Covid 19 dhe Institucionet përkatëse të nivelit lokal dhe Qendror.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Shtojcë: Lista e anëtarëve të QOEL

Nr. 02-016/01-0020536/20
Podujevë, 14 prill 2020

Nënkyetari i Komunës
Nexhmi Rudari





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



ZYRA E KRYETARIT

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-02/01-0050862/18, nenet 8 dhe 15 të Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400, Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarjen e mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400 dhe Vendimin për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2020 dhe parashikimet buxhetore 2021-2022 nr.01-400/03-0075925/19, dt. 23.09.2019, në rekomandim të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës Nr. 02-020/04-0011787/19, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, sipas Ftesës Publike nr. 12-320/01-0015564/20, dt. 27.02.2020, në pajtim me shkresën e MAPL-së nr. 02-129/2 datë 06.02.2020, Nënkryetari i Komunës, merr:

VENDIM PËR MBËSHTETJEN E FERMERËVE NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Mbështeten 62 (gjashtëdhjetë e dy) fermerë përfitues nga Komuna e Podujevës, në projektin “Përkrahja e fermerëve me sistemin e ujitjes pikë pikë në perimkulturë dhe pemë të imta, për sipërfaqe nga 0.50 ha”, në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë Pyltariisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 2

Mbështetja e fermerëve bëhet me qëllim të promovimit dhe zhvillimit të bujqësisë në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 3

Lista e përfituesve sipas nenit 1 është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Neni 4

Zbatimin e Vendimit e bënë Drejtoria e Bujqësisë Pyltariisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. 02-320/01-0020561/20
Podujevë, 15 prill 2020





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

ZYRA E KRYETARIT

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenet 9.1 dhe 13.2), 3) të Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400 dhe Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 02-020/04-0011787/19, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, në pajtim me shkresën e MAPL-së nr. 02-129/2 datë 06.02.2020, Nënkryetari i Komunës, merr:

VENDIM

PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PERSONAVE NË GJENDJE TË RËNDË SOCIALE E SHËNDETËSORE

Neni 1

Njëqind e njëmbëdhjetë (111) personave në gjendje të rëndë sociale-ekonomike dhe shëndetësore u jepet ndihmë financiare, në shumë të përgjithshme 11,850 €.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Shuma e mjeteve individuale nuk tejkalon shumën e mjeteve financiare sipas Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere.

Neni 3

Lista e përfituesve të ndihmës financiare është pjesë përbërëse e Vendimit.

Neni 4

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.02-400/03-0020562/20
Podujevë, 15 prill 2020





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



ZYRA E KRYETARIT

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-02/01-0050862/18, nenet 8 dhe 15 të Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400, Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarjen e mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400 dhe Vendimin për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2020 dhe parashikimet buxhetore 2021-2022 nr.01-400/03-0075925/19, dt. 23.09.2019, në rekomandim të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.02-020/04-0011787/19, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, sipas Ftesës Publike nr. 12-320/01-0007661/20, dt. 31.01.2020, në pajtim me shkresën e MAPL-së nr. 02-129/2 datë 06.02.2020, Nënkryetari i Komunës, merr:

VENDIM

PËR NDARJEN E SERRAVE FERMERËVE NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Ndahen 100 (njëqind) serra për fermerët përfitues nga Komuna e Podujevës, në projektin “Përkrahja e fermerëve në projektin për ndarjen e serrave, në madhësi nga 100 m²”, në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 2

Ndarja e serrave bëhet me qëllim të promovimit dhe zhvillimit të bujqësisë në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 3

Lista e përfituesve sipas nenit 1 është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Neni 4

Zbatimin e Vendimit e bënë Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. 02-320/01-0020996/20
Podujevë, 28 prill 2020

